

Universiteti Prizren "UKSHIN HOTI"	
Pranuar rrejt. dt.	22.03.2022
Zyra e pranimit	Nr. i protokollit
308	01-119



Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren
University "Ukshin Hoti" Prizren

FAKULTETI I SHKENCAVE TË JETËS DHE MJEDISIT

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren - Kosovë; Tel: +381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Me objekt: Kryerja e Praktikës Profesionale për Studentët e nivelit bachelor dhe master në Fakultetin e Shkencave të Jetës dhe Mjedisit (më tej FSHJM të Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren (më tej Universiteti)

NENI 1

Institucioni//Ndërmarrja: AGRONOMI GRUP Shpk
e përfaqësuar nga Z/Zj. Mr.sc. Refki Zogaj me detyrë Drejtor dhe Fakultetit të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit (FSHJM) përfaqësuar nga Prof. Asoc. Dr. Isuf Lushi, me detyrë Dekan i këtij Fakulteti, lidhin me vullnet të lirë këtë kontratë.

NENI 2

Institucioni//Ndërmarrja merr persiper:

1. Të presë, të asistojë teknikisht dhe të monitorojë për një semestër të vitit akademik studentin/tët duke caktuar një nga punonjësit e vet si udhëheqës të tij. Udhëheqësi të jetë një specialist me përvojë sa më të madhe të jetë e mundur dhe sa më afër profesionit të studentit dhe objektivave të praktikës.
2. Të krijojë sa të jetë e mundur kushte lehtësuese, si vendqëndrim të përkohshëm në një zyrë, transport brenda zonës së praktikës brenda mundësive duke shfrytëzuar udhëtimet e automjeteve të veta për qëllime pune.
3. Të vlerësojë me shkrim punën, angazhimin dhe efektivitetin e praktikës profesionale të studentit, duke u ndalur veçanërisht në përfitimet e realizuara prej tij dhe në

sugjerimet për fakultetin me qëllim përmirësimin e praktikës së studentëve të tjerë në të ardhmen.

Vlerësimi i percillet zyrtarisht fakultetit në fund të praktikës.

NENI 3

Gjatë kohës së praktikës studenti zbaton orarin dhe detyrat që i cakton udhëheqësi në përputhje me kërkesat e programit të praktikës dhe me përmbajtjen e kësaj kontrate.

NENI 4

Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit (FSHJM) merr përsipër:

1. Të dërgojë studentin/tët e FSHJM në praktikë në afatin e caktuar.
2. Të mbajë lidhje dhe të komunikojë me ndërmarrjen për problemet eventuale dhe për ecurinë e praktikës.
3. Të kontrollojë herë pas here procesin e kryerjes së praktikës nga studenti me qëllim dhënien e ndihmës dhe rritjen e efektivitetit të saj.
4. Të vlerësojë praktiken e kryer nga studentët në përfundim të saj.

NENI 5

Mosmarveshjet eventuale midis palëve do të zgjidhen me bashkëbisedim ose konsensus të dyanshëm.

U lidh me datën: 22. 03. 2022

Për Institucionin/Ndërmarrjen

Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren

Fakultetin e Shkencave të Jetës dhe Mjedisit

DREJTORI

Msc. Refki ZOGAJ



REKTORI

Prof. Asoc. Dr. Samedin Krrabaj

